

Vendim nr. 165 datë 17.07.2024

Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Holta Zaçaj, Kryetare, Marsida Xhaferllari, Fiona Papajorgji, Elsa Toska, Sonila Bejtja, Sandër Beci, Ilir Toska, Genti Ibrahim, Marjana Semini, anëtarë, në datën 17.07.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 7 (G) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **GËZIM KODRA**, përfaqësuar nga avokat Ledio Braho, me prokurë.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2024-65 (26), datë 18.01.2024 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 18, 42, pika 2, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese (*Mbledhja e Gjyqtarëve*), pasi dëgjoji relatorin e çështjes Marjana Semini, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi Gëzim Kodra ka ushtruar detyrën e përgjegjës të sektorit të analizës dhe menaxhimit të riskut në Drejtorinë e Financës në Ministrinë e Mbrojtjes. Me vendimin nr. 77 prot., datë 08.01.2014 të sekretarit të përgjithshëm të Ministrisë së Mbrojtjes, për kërkuesin është

vendosur kalimi në listë pritje për shkak të ristrukturimit të institucionit, vendim i cili ka hyrë në fuqi në datën 08.02.2014. Kërkuesi është njoftuar për këtë vendim me shkresën nr.1007/1 prot., datë 11.02.2014, për të cilën ka pretenduar se ka marrë dijeni efektivisht në datën 19.02.2014. Duke mos qenë dakord me këtë vendim, në datën 20.03.2014, kërkuesi i është drejtuar me kërkesëpadi gjykatës me objekt konstatimin e pavlefshmërisë absolute të vendimit të kalimit në listëpritje dhe detyrimin e palës së paditur ta kthejë në një pozicion tjetër të Shërbimit Civil të së njëjtës kategori.

2. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 5013, datë 23.09.2014, ka vendosur pranimin e pjeshëm të padisë; konstatimin si absolutisht të pavlefshëm të vendimit nr. 77 prot., datë 08.01.2014 të sekretarit të përgjithshëm të Ministrisë së Mbrojtjes; detyrimin e palës së paditur ta rikthejë kërkuesin në Shërbimin Civil, duke realizuar transferim, sipas nenit 50/2 të ligjit nr. 152 datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil” (*ligj nr. 152/2013*), në Drejtorinë e Financave në Ministrinë e Mbrojtjes në pozicionin e përgjegjës të sektorit; pagimin e pagës deri në momentin e rikthimit në punë; rrëzimin e kërkimit të padisë për pjesën e pambështetur në ligj dhe në prova. Kjo gjykatë ka arsyetuar se padia është depozituar në gjykatë në datën 20.03.2014 dhe kërkuesi është njoftuar efektivisht për kalimin në listë pritjeje në datën 19.02.2014. Me shfuqizimin nga Gjykata Kushtetuese (*Gjykata*) me vendimin nr. 5, datë 05.02.2014 (*vendim nr. 5/2014*) të aktit normativ të Këshillit të Ministrave nr. 5, datë 30.09.2013, për gjykatën bëhet i zbatueshëm ligji nr. 152/2013. Ky vendim i Gjykatës ka fuqi prapavepruese në zgjidhjen e çështjes objekt gjykimi, në bazë dhe për zbatim të nenit 76 të ligjit organik të Gjykatës. Për rrjedhojë, gjykata ka konstatuar paligjshmërinë e procedurës së ndjekur dhe vendimmarrjes së sekretarit të përgjithshëm në raport me parashikimet e ligjit nr.152/2013. Kundër këtij vendimi ka ushtruar ankim pala e paditur, Ministria e Mbrojtjes dhe Departamenti i Administratës Publike.

3. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 2995, datë 30.09.2016, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë me arsyetimin se ligji nr. 152/2013 është i zbatueshëm për rastin objekt shqyrtimi dhe i shtrin efektet e tij nga data 01.10.2013, datë e hyrjes në fuqi të tij, për sa kohë për këtë çështje nuk ka ende një vendim të formës së prerë, për shkak se kjo çështje është në gjykim nga kjo gjykatë si dhe për pasojë të rrëzimit të shkakut që shtynte efektet ligjore të këtij ligji. Ndaj këtij vendimi kanë paraqitur rekurs Ministria e Mbrojtjes dhe Departamenti i Administratës Publike.

4. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-65 (26), datë 18.01.2024, ka vendosur prishjen e vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim pranë kësaj gjykate, me tjetër trup gjykues. Ky kolegji ka arsyetuar se padia është paraqitur për gjykim pas datës 26.02.2014 kur ka hyrë në fuqi vendimi i Gjykatës që shfuqizonte aktin normativ nr. 5/2013, duke mos pasur fuqi prapavepruese. Vendimi nr. 5/2014 i Gjykatës do të kishte fuqi prapavepruese nëse çështja do të kishte qenë në shqyrtim në kohën e marrjes së tij, i cili ka hyrë në fuqi në datën 26.02.2014, pas botimit në Fletoren Zyrtare nr.18, datë 26.02.2014. Ndërkohë që padia e kërkuarit është depozituar në gjykatë në datën 20.03.2014, pra nuk e ka gjetur në shqyrtim mosmarrëveshjen objekt shqyrtimi. Për këto arsye, sipas Gjykatës së Lartë, Gjykata Administrative e Apelit ka gabuar kur e ka zgjidhur mosmarrëveshjen në zbatim të dispozitave të ligjit nr.152/2013, i cili nuk gjen zbatim në rastin konkret. Ndaj në rigjykimin e kësaj çështjeje Gjykata Administrative e Apelit duhet të marrë në analizë pretendimet e parashtruara nga palët në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil" (ligji nr. 8549/1999), për të konkluduar nëse është rasti i pavlefshmërisë absolute/relative apo i një akti të nxjerrë në zbatim të ligjit.

5. Në datën 14.05.2024 kërkuari i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij, i cili, pasi është plotësuar sipas parashikimeve të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 22.05.2023.

II

Pretendimet e kërkuarit

6. **Kërkuari**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se vendimi i Gjykatës së Lartë i ka cenuar:

6.1. *Të drejtën për proces të rregullt ligjor*, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të *së drejtës së aksesit*, pasi kërkuari është njoftuar për lirimin nga shërbimi civil në datën 19.02.2014 dhe nuk mund të parashikonte momentin kur do të botohej vendimi i Gjykatës nr. 5/2014. Interpretimi i Gjykatës së Lartë se ky i fundit nuk ka fuqi prapavepruese i ka cenuar aksesin në gjykatë, pasi nëse kërkuari do të priste datën e publikimit të vendimit, afati për të paraqitur ankim do të kufizohej vetëm në 7 ditë.

6.2. *Parimin e barazisë përpara ligjit*, pasi në çështje të ngjashme dhe me specifika të njëjta, ndonëse padia është ngritur pas hyrjes në fuqi të vendimit nr. 5/2014 të Gjykatës, Gjykata e Lartë ka interpretuar se ky i fundit ka fuqi prapavepruese për çështjet që janë në gjykim ose ndaj atyre ku palët janë brenda afatit ligjor të ankimit dhe paraqesin padi brenda këtij afati. Kërkuesi ka ushtruar të drejtën e ankimit brenda afatit 45-ditor, për rrjedhojë vendimi i Gjykatës ka fuqi prapavepruese dhe marrëveshja në gjykim rregullohet sipas ligjit nr. 152/2013.

III

Vlerësimi i Mbledhjes së Gjyqtarëve

A. Për legjitimitimin e kërkesit

7. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është vlerësuar nga Gjykata si një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Kriteret për pranueshmërinë e kërkesës janë kumulative, në kuptimin që mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjyimit kushtetues.

8. Kërkuesi, si individ, legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor ndaj të cilit ka ngritur pretendime në këtë Gjykatë dhe ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

9. Një kriter tjetër paraprak është *shterimi i mjeteve juridike efektive*, që përcaktohet nga neni 131, pika 1, shkronja “f”, i Kushtetutës, sipas të cilit Gjykata bën gjykimin përfundimtar të ankesave individuale kundër çdo vendimi gjyqësor, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore kushtetuese që pretendohet se janë cenuar.

Ky kriter kërkon shfrytëzimin në rrugë normale të mjeteve juridike efektive, të cilat janë të përshtatshme, të disponueshme dhe efikase për një çështje konkrete. Shterimi i mjeteve juridike efektive ka të bëjë me kontrollin subsidiar që ushtron Gjykata, përfshirë edhe rastet e shkeljes së të drejtave të individit (*shih vendimin nr. 56, datë 25.07.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Duke qenë se mbrojtja kushtetuese ka një funksion subsidiar, kjo do të thotë se mund të kërkohej vetëm për një vendim gjyqësor përfundimtar që përmbyll procesin gjyqësor (*shih vendimin nr. 48, datë 06.07.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

10. Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se kërkuksi i është drejtuar Gjykatës për shfuqizimin e vendimit të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, i cili ka vendosur prishjen e vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit dhe kthimin e çështjes për rishqyrtim, për shkak se kjo e fundit ka zbatuar gabim dispozitat ligjore për zgjidhjen e mosmarrëveshjes në gjykim. Kërkuksi ka pretenduar se ka përmbushur kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, pasi vendimi i Gjykatës së Lartë, ndonëse ka kthyer çështjen për rishqyrtim në gjykatën e apelit, është detyrues për sa u përket detyrave të lëna për këtë gjykatë, për rrjedhojë ai përbën një ndërthurje midis vendimit të ndërmjetëm dhe atij përfundimtar dhe ka një masë autonomie. Sipas kërkuksit, çdo vendimmarrje e gjykatës së apelit nuk është e aftë të ndryshojë vendimin objekt gjykimi kushtetues për sa i përket ligjit të zbatueshëm dhe as të riparojë efektet që ai ka sjellë.

11. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka pohuar se vendime të këtij lloji nuk mund të konsiderohen si vendime përfundimtare, për efektet e gjykimit kushtetues, pasi ato nuk vendosin në mënyrë përfundimtare për themelin e çështjes. Në të tilla raste, kur procesi i themelit vazhdon të jetë në gjykim, kërkuksi i ka të gjitha mjetet e nevojshme juridike për mbrojtjen e interesave të tij gjatë rigjyimit të çështjes, përfshirë më pas edhe mbrojtjen kushtetuese në këtë Gjykatë (*shih vendimet nr. 59 datë 14.11.2023; nr. 39, datë 06.07.2016; nr. 48, datë 06.07.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). Megjithatë, përjashtimisht nga rregulli i parashikuar në nenin 131, pika 1, shkronja “F”, të Kushtetutës, kontrollit kushtetues mund t’i nënshtrohen edhe vendime të tilla, me natyrë jo përfundimtare, që jepen gjatë një procesi gjyqësor, nëse plotësohen disa kritere që lidhen me pasojat e drejtpërdrejta ndaj së drejtës kushtetuese të individit (*shih vendimin nr. 59, datë 14.11.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se edhe pse Gjykata e Lartë duket që e ka udhëzuar gjykatën e apelit se cili është ligji i zbatueshëm në zgjidhjen e mosmarrëveshjes konkrete, çështja e kërkuksit nuk ka përfunduar së shqyrtuari ende në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm. Për këtë

shkak, Gjykata, e cila referuar parashikimit të nenit 131, shkronja “f”, të Kushtetutës bën gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve, nuk mund të investohet në këtë fazë. Në këtë drejtim Mbledhja e Gjyqtarëve e vlerëson jo bindës argumentin e kërkuarit se vazhdimi i gjykimit në shkallë të dytë dhe eventualisht sërish në Gjykatën e Lartë nuk e bën mjetin efektiv. Për më tepër, kërkuari ka mundësi që nëpërmjet mjeteve të tjera që ka në dispozicion (rekursit ose parashtimeve të tij) të kërkojë njësimin ose unifikimin e praktikës gjyqësore. Për sa u takon pretendimeve të kërkuarit, të cilat në thelb lidhen edhe me parimin e zbatimit të detyrueshëm të vendimeve të Gjykatës dhe posaçërisht me veprimin në kohë të tyre (efektet), bazuar në parimin e subsidiaritetit që udhëheq raportet ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme, ato merren në shqyrtim vetëm pasi gjykatat e zakonshme të kenë mbajtur një qëndrim të shprehur lidhur me to me vendim përfundimtar që përmbyll procesin gjyqësor.

13. Në përfundim, Mbledhja e Gjyqtarëve çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për pranimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Mbledhja e Gjyqtarëve, bazuar në nenet 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “d”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.